

„Kompetent gjuhësor që nga fillimi“ – Fletat udhëzuese U3 – U5 Këshilla për praktikimin e shumëgjuhësisë në familje

Të dashur prindër,

Edhe ne gëzohemi për lindjen e fëmijës Tuaj.

Ju flisni gjermanisht dhe/ose gjuhë të tjera, kështu që fëmija Juaj ka shanse të rritet me më shumë gjuhë. Ju tanimë me siguri keni menduar lidhur me atë se në cilën gjuhë do të kishit dashur të flitni me fëmijën Tuaj.

Në vazhdim lexoni udhëzimet e rëndësishme për një praktikim të suksesshëm të gjuhëve të ndryshme.

Shumëgjuhësia është një shans

Të rritesh me më shumë gjuhë nuk është ndonjë përjashtim, por shikuar globalisht, për një numër të madh të njerëzve kjo është përditshmëri jetësore.

Mësimi i më shumë gjuhëve, për fëmijën Tuaj është një pasurim i madh. Në veçanti fëmijët e vegjël shumë lehtë mund të mësojnë më shumë gjuhë dhe kjo për ta nuk është mbingarkesë. Te fëmijët që mësojnë më shumë gjuhë, shqetësimet (defektet) në zhvillimin gjuhësor shfaqen më rrallë në krahasim me ata fëmijë që janë rritur me një gjuhë. Fëmijët që zotërojnë shumë gjuhë kthesat epokale në zhvillimin gjuhësor ngandonjëherë i arrijnë pak më vonë. Prapambetjet zakonisht kompensohen shpejt.

Si duhet të flas me fëmijën tim?

- **Me fëmijën Tuaj flisni qetë dhe vetëm në atë gjuhë, të cilën Ju e dini më mirë, edhe sikur ajo të mos jetë gjuha gjermane.**

Zakonisht nuk paraqet kurrfarë problemi nëse fëmija Juaj në fillim rritet vetëm me një gjuhë tjetër amtare dhe pak më vonë gjermanishten e mëson si gjuhë të dytë.

- **Po qe se Ju si prindër flisni gjuhë të ndryshme, atëherë do të ishte më mirë që secili prej jush me fëmijën të flasë në gjuhën e vet amtare.**

Fëmija Juaj do të mësojë shumë shpejt se ekziston një „gjuhë e nënës“ dhe një „gjuhë e babës“ dhe se ai që nga fillimi njëkohësisht mund të mësojë mirë më shumë gjuhë. Fëmijës Tuaj mund t’ia lehtësoni mësimin e gjuhës Tuaj,

duke biseduar, duke bërë shaka, duke kënduar, duke e ngushëlluar në gjuhën Tuaj amtare etj.

- **Është me rëndësi që gjermanishtja të dëgjohej sa më herët.**

Për të arritur një integrim dhe një sukses të mëvonshëm në shkollë, për fëmijën Tuaj është shumë e rëndësishme që gjuhën gjermane ta zotërojë mirë. Prandaj fëmijës Tuaj duhet t’i ofrohet mundësia që gjermanishten të fillojë ta dëgjojë me kohë, dhe më vonë të mund edhe të flasë në këtë gjuhë.

Kontakti me të rriturit dhe me fëmijët, p.sh. në ndonjë grup të fëmijëve të vegjël (sikur grupi i çamarrokëve), fëmijës Tuaj i ndihmon shumë, sidomos për ta mësuar gjermanishten.

Të respektohet gjuha amtare përkatëse dhe gjuha gjermane

Se sa me qejf dhe para së gjithash, sa mirë do t’i mësojë fëmija Juaj gjuhët, kjo varet shumë nga respektimi i gjuhëve të caktuara. Tregoni fëmijës Tuaj se Ju jeni krenar me gjuhën Tuaj amtare, por gjithashtu tregoni se sa e rëndësishme është zotërimi i gjuhës së shtetit në të cilin Ju jetoni. Po qe se Ju ende nuk e flisni mirë gjermanishten, do të ishte me rëndësi që Ju, sa më shpejt që është e mundur, ta ndiqni një kurs të gjermanishtes. Prandaj për të arritur një shumëgjuhësi të suksesshme, duhet që të gjitha gjuhët të vlerësohen pozitivisht dhe të përdoren në mënyrë aktive.

Pra, fëmija Juaj mund ta bëjë këtë

Fëmijët që në fillim janë „ekspertë gjuhësorë“ të vegjël. Ata tanimë mund ta dëgjojnë gjuhën para lindjes. Ata e njohin zërin e nënës së tyre dhe me gjithë qejf e dëgjojnë gjuhën e saj amtare. Në mësimin e gjuhës bëjnë pjesë edhe britmat, qeshjet dhe zhurmat. Gugatja është një shkallë paraprake e rëndësishme për fjalët e para dhe fillon me rreth një vit e gjysmë.

Kështu pra mund ta mbështetni fëmijën Tuaj në zhvillimin e gjuhës

- **Gugatni dhe flisni me fëmijën Tuaj.**

Në vitin e parë të jetës shoqërimi/kontakti i gëzueshëm dhe me lojëra me gjuhën është i rëndësishëm. Me fëmijën Tuaj flisni më shumë bashkërisht. Kjo vlen edhe atëherë kur fëmija nuk flet asnjë fjalë. Përsëritni (imitoni) tingujt dhe zhurmat që i bën fëmija Juaj, dhe pritni se si do të reagojë me këtë rast. Kështu mund të zhvillohet një „bisedë“ e vërtetë ndërmjet Juve dhe fëmijës Tuaj – vetëkuptohet, pa fjalë.

- **Vështrimi në sy, përsëritja dhe theksimi i mirë.**

Kur flisni me fëmijën Tuaj, shikojeni atë në sy. Flisni ngadalë dhe me fjali të thjeshta. Po qe se fjalët e rëndësishme i përsërisni shpesh dhe ato i theksoni në veçanti, me këtë ia lehtësoni fëmijës Tuaj mësimin e këtyre fjalëve.

- **Emërtoni sendet, për të cilat fëmija Juaj tregon interesim.**

Fëmijën Tuaj vështroni mirë dhe emërtoni sendet për të cilat ai është i interesuar. Ose tërheqjani vëmendjen në ndonjë objekt dhe emërojeni atë sapo fëmija Juaj ta kthejë shikimin drejt objektit. Sidomos, krijoni situata të tilla, në të cilat do të jeni vetëm me fëmijën Tuaj, p.sh. kur e vëni në gjumë, kur e mbështjellni, kur e lani, kur lozni me të.

- **Në veçanti është mirë, që gjatë „bisedave“ me fëmijën (beben) Tuaj, ta fikni radion dhe televizorin.**

Kështu fëmija Juaj më mirë do ta përqendrojë vëmendjen te Ju dhe te gjuha Juaj. Kjo e lehtëson mësimin e gjuhës.